



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV

Kryesia e Kuvendit

P-088

Prishtinë, më 17 dhjetor 2012, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

P R O C E S V E R B A L

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 17 DHJETOR 2012

Në mbledhje morën pjesë: Xhavit Haliti, Sabri Hamiti, Glauk Konjufca, Petar Miletqi dhe Enis Kervan, nënkryetarë të Kuvendit.

Nga grupet parlamentare: Adem Grabovci, Ismet Beqiri, Visar Ymeri, Burim Ramadani Myzejane Selmani, Sasha Milosavleviq dhe Myfera Shinik.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit: Eshref Vishi;

Nga Administrata e Kuvendit: Daut Beqiri, Sali Rexhepi, Shefki Shoshaj dhe Sherif Konjufca;

Nga: Zyra e Presidentit: Amir Haradinaj dhe

Nga: OSBE-ja: Floriana Shala.

Mbledhjen e kryesoi **Xhavit HALITI**, nënkryetar i Kuvendit.

Kryesuesi e hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit të ditës.

Ai propozoi që rendit të ditës t'i shtohet edhe një pikë shtesë.

Kryesia, me propozimin e kryesuesit, i zhvilloi punimet me këtë:

R e n d d i t e

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 10 dhjetor 2012,
2. Përgatitjet për mbledhjen plenare të radhës,
3. Shqyrtimi i propozimeve dhe kërkesave.

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 10 dhjetor 2012

Kryesia e miratoi pa vërejtje procesverbalin e mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 10 dhjetor 2012.

Nënkryetari i Kuvendit **Sabri Hamiti** bëri vërejtje në mënyrën dhe formën e transkriptimit të mbledhjeve të Kryesisë. Ai propozoi që transkriptimi të bëhet më ndryshe, të krijohet një standard në lidhje me këtë, ngase nganjëherë bisedat aty zhvillohen në kuptimin kolegjial dhe jo çdo herë zyrtar.

2. Përgatitjet për mbledhjen plenare të radhës

Kryesia, pasi i shqyrtoi përgatitjet e nevojshme për secilën pikë veç e veç, me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare, vendosi që mbledhja plenare e Kuvendit të mbahet të enjten, më 20 dhjetor 2012, me këtë:

R e n d d i t e

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Miratimi i procesverbalit të seancës së mëparshme,
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për gjykatat,
5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për procedurën përmbartimore,
6. Shqyrtimi i Raportit të punës të Këshillit Gjyqësor të Kosovës për vitin 2011.

3. Shqyrtimi i rekomandimeve dhe kërkesave

1. Kërkesa e deputetit Ramiz Lladrovci, i mbështetur nga deputetët nënshkrues, për debat parlamentare lidhur me rastin Kiçina

Kryesia, me kërkesë të deputetit Ramiz Lladrovci, e shtyu kërkesën për debat parlamentare lidhur me rastin Kiçina për njërin nga mbledhjet e radhës.

2. Rekomandimi i Komisionit për Legjislacion lidhur me amendamentet kushtetuese, të propozuara nga Qeveria e Republikës së Kosovës

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me rekomandimin e lartshënuar, nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

Kërkohet nga Qeveria e Republikës së Kosovës që, në cilësinë e propozuesit, të bëjë riformulimin e propozimit të amendamentit 1 në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, që ka të bëjë me amnistinë, në pajtim me aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese nr. KO-61/12.

3. Njoftimi i Komisionit Parlamentar për Mbikëqyrjen e Financave Publike lidhur me vizitën zyrtare, të realizuar në Poloni

Kryesia u njoftua për vizitën e Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike, të realizuar në Poloni, prej datës 4-6 dhjetor 2012.

Pika shitesë:

1. Propozim-Rezoluta e Partneritetit për Ndryshimin dhe Fuqizimin e Rolit të Gruas, nga deputetja Flora Brovina dhe grupi i deputetëve nënshkruese

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me propozim-rezolutën e lartcekur, vendosi që kjo çështje të procedohet sipas rregullores së Rregullores së Kuvendit.

Kryesuesi e deklaroi të mbyllur mbledhjen e Kryesisë në orën 11:25 minuta.

Kryetari i Kuvendit

Jakup KRASNIQI

Procesverbalin e hartoi: Drejtoria për Çështje Plenare dhe Procedurale